



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKPP
 Nr. Prot. 01-2087/16
 Br. Prot. 01-2087/16
 Prot No. 01-2087/16
 Nr. i faq. 02
 Data 20.06.2016
 Broj stranica 02
 Datum 20.06.2016
 Nr. pages 02
 Date 20.06.2016

Republika e Kosovës



Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	20/06/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP – 03-03/2009/16
PËR/ZA/TO:	z. Besim TAHIRI u.d.Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit - Ministria e Infrastrukturës
CC:	z. Xhelil BEKTESHI Sekretar i Përgjithshëm - Ministria e Infrastrukturës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Asfaltimi i Rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë (faza e II-të)”

I nderuar z. TAHIRI

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nën par. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nën par. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nën par. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Asfaltimi i Rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë (faza e II-të)” me numër prokurimi: MI/16/073/511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: “Asfaltimi i Rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë (faza e II-të)” me numër prokurimi: MI/16/073/511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: “Asfaltimi i Rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë (faza e II-të)” me numër prokurimi: MI/16/073/511, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 30/05/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur - punë.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në kritere që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Njoftim për Kontratë dhe në Dosja e Tenderit “Asfaltimi i Rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë (faza e II-të)” tek Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale pika 9.1, keni kërkuar që menaxheri i projektit të jetë: *Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve) në vlerën prej minimum 500,000.00 euro*, si dhe është keni kërkuar që udhëheqësi i punishtes të jetë: *Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë me 2 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar. Vlera e projekteve të udhëhequra të jetë minimum sa 500,000.00 euro*.

Sipas neni 23 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues ka të drejt që në kuadër të kërkesave mbi Aftësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkoj kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxhues dhe CV-të e tyre, por jo edhe të bëjë kufizime të tilla mbi vlerën e projekteve të udhëhequra.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenin 23 Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t’i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !